

TRAJTIMI I DOKUMENTACIONIT NË ARKIVAT E LIPJANIT

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I ARKIVËS

NGA

Emine Dedushi-Aliu

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I HISTORISË

Korrik, 2022

REZYME E TEMES MASTER

Trajtimi i dokumentacionit arkivor në Arkivat e Lipjanit

Kandidatja: Emine Dedushi-Aliu

Mentori: Prof.Asoc.Dr.Muhamet Qerimi

“Trajtimi i dokumentacionit arkivor në Arkivat e Lipjanit” është titulli i temes së masterit

Arkivi është institucion publik që evidencon, merr, ruan, rregullon, përpunon, boton lëndën arkivore dhe mundëson shfrytëzimin e saj për punë hulumtuese-shkencore, profesionale dhe arsimore-edukative si dhe për nevojat tjera me interes publik për organet shtetërore, institucionet dhe organizatat e bashkësit e tjera, për punonjësit dhe qytetarët.

Përmes kësaj teme jam munduar të paraqes gjendjen reale të Arkivit Komunal të Lipjanit.

Struktura e këtij punimi është ndarë në tre kapituj, ky studim përmbledh rreth 74 faqe.

Kapitulli i parë paraqet historikun e komunës së Lipjanit të ndarë në statutin e Komunës, drejtoritë komunale dhe pasuritë natyrore. Nga antika e vjeter emri Lypenion, Lypjana pa dyshim vijm deri te emri i tashëm Lipjan. Komuna e Lipjanit ka një pozitë shumë të përshtatshme gjeografike pasi shtrihet në rrafshin e Kosovës dhe gjendet në pjesen qendrore të Republikës së Kosovës.

Statuti i Komunës është akti më i lartë juridik i Komunës. Me statutin e ri të ndarë në nëntë kapituj specifikon qartë organizimin dhe funksionimin e Kuvendit Komunal të Lipjanit. Ndarja e pushtetit lokal përfshin drejtoritë Komunale si organ që funksionon dhe merret me organizimin dhe funksionimin e jetes së qytetarëve të komunës. Në kuadër të Drejtoratit për Kulturë Rini dhe Sport vepron sektori i veçant, arkivi i Qytetit të Lipjanit. Në të ruhen dokumente të ndryshme. Përgaditjet për themelimin e arkivit janë bërë me 1979, përkatësisht 1980 është bërë themelimi i Arkivit Komunal nga institucionet e atëherëshme Komunale. Ka poseduar prej 22 fonde që ka përfshirë perioden kohore prej 1945-1975. Kurse me 02.11.2015 zyrtarisht arkivi është vendosur në objekt të ri. Sektori i arkivit ka 343 m² hapsirë, me depo prej 250m² për hulumtim. Materiali i takon periodes 1945-1999 dhe kryesisht i përket si material organeve shtetërore të Komunës. Materiali arkivor ruhet dhe shfrytëzohet për nevoja arsimore, shkencore, hulumtuese etj. Pasiqë pasuritë janë thesar edhe Komuna e Lipjanit ka mjaft pasuri natyrore ku komuna gjeneron të hyra përmes formave të ndryshme me plane për funksionalizimin dhe organizimin e tyre publik.

Disa nga pasuritë natyrore të Komunës sonë janë: Shpella e Gadimes, Miniera e Magnezit në Golesh, Xeherorja Feronikeli Medvec, Parku Nacional Blinaja etj.

Kapitulli i dytë si temë trajtimi ka dokumentacionin në arkivin e Lipjanit, për fondet që posedon, llojet e fondeve, rregullimin dhe përpunimin e lëndës, qasjen në dokumente. Fondin e përbëjnë tërësia e dokumenteve pamarr parasysh formen ose bartësin të cilin në mënyrë organike e ka krijuar

ose e ka grumbulluar dhe shfrytëzuar ndonjë individ, familje ose përsôn juridik në kuadër të kryerjes së veprimatrisë dhe funksionit të vet.

Kemi fond Arkivor Kombëtar, familjar dhe fond përsônal. Rregullimi i lëndës arkivore është veprimtari arkivore me të cilën lëndës arkivore, përkatësisht pjesëve të saj u caktohet vendi i përhershëm. Lënda arkivore rregullohet sipas parimevë dhe standarteve bashkëkohore.

Ndër parimet themelore janë Provinienca ku sipas këti parimi lënda e krijuar me punën e një krijuesi duhet të jet organizuar dhe të ruhet në një tërësi që quhet fond arkivor. Parimi i provinienca së lirë, në vendin tonë zbatohet edhe ky parim që respekton tërësin dhe vitet kufitare të fondit. Përpunimi i lëndës arkivore ka për qëllim që të përcaktohet gjendja numerike e njësive arkivore dhe vendi i tyre në kuadrin e tërësive të caktuara arkivore. Gjatë përpunimit të lëndës arkivore hartohen edhe mjetet informative. Ky mjet është i rëndësishëm për zbulimin e përmbajtjes dhe të përmërjes së dokumenteve për evidencimin e sistemit të ruajtjes së tyre. Sininim i përpunimit përdoret edhe nocioni i përshkrimit të lëndës.

Standardi ndërkombëtar I përgjithshëm për përshkrimin e lëndës arkivore është ISAD(G). Të gjithë përsônat fizik, juridik dhe civilo-juridik kanë të drejtë të shfrytëzimit të lëndës arkivore. Lënda arkivore në arkiv shfrytëzohet për punë shkencore-kërkimore dhe profesionale, enteve, organizatave etj. Lënda arkivore jepet në shfrytëzim 30 vite pas krijimit të saj.

Në kapitullin e tretë do të trajtoj Institucionet Arsimore në Komunën e Lipjanit. Shkollat kanë dhënë dhe vazhdojnë të kontrbojnë në jetën shoqërore-kulturore në ngritjen e arsimimit. Mund të themi që në Janjevë ka ekzistuar shkolla e parë fetare e hapur me 1665 ku kanë mësuar nxënës nga të gjitha anët e Kosovës. Në vitin 1968/69 hapet gjimnazi i mesëm me dy paralele një në gjuhën shqipe dhe atë serrbe. Shkollat fillore janë hapur në vitin 1866 ndërsa ato të mesme më von. Mësimi zhvillohej në mejtepe dhe ishte mësim fetar kryesisht në gjuhën turke dhe arabe. Këto formate zgjaten deri në fillimin e luftërave Ballkanike. Pastaj në vitin 1918 me përfundimin e Luftës së Parë Botërore filloj riorganizimi i punës në shkollë. Në vitin 1941 me fillimin e Luftës së Dytë Botërore për të rifilluar në vitin 1945-46. Gjenarata e parë e semimaturanteve që dolën nga shkollimi ishin viti 1952-1953.

Si konkluzion, arkivi komunal është institucion i rëndësishëm që kryen veprimtarin arkivore kryesisht për nevojat e komunës.